



01/Nr.7683/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 24, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-48 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkoret Buxhetore 2019/01 me nr. 01/950 dhe 2019/02 me nr.01/1520 për Komunat, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2018 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT 2019 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2020-2021 TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për buxhetin e Komunës për vitin 2019, në shumë prej 2,915,921 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2020 janë në shumë prej 2,625,529 € dhe për vitin 2021 janë në shumë prej 2,717,700 €.

II

Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2019 sipas pikës I të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 2,600,554 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 89.18%, nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 289,129 € apo 9.92%, ndërsa financimi nga huamarrjet në shumë prej 26,238 € apo 0.90%.

III

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2019 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe mëditje 1,493,148 €, mallra dhe shërbime 263,236 €, shpenzime komunale 54,400 €, subvencione dhe transfere 61,104 € dhe shpenzime kapitale 1,044,043 €.

IV

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë tabelat e buxhetit për vitet 2019-2021 (tabelat 4.1, 4.2 dhe 4.3).

V

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës .

VI

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave-Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.09.2018





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.7704/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-87, neni 5 pika 2. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2018 merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale për mbeturina.

II

Komisioni komunal i aksionarëve do të këtë përbërje:

1. Nuriman Kuka
2. Isni Bushi
3. Kujtim Dernjani

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Më këtë vendim shfuqizohet vendimi me numër 01.nr.1268/2016, i datës 28.01.2016 për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve.

V

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.09.2018





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.8145/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 06/L-020 për vitin 2018, neni 3, paragrafi 1.29, 1.30 dhe neni 16 paragrafi 3, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2018 merr:

VENDIM
PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORINË SHPENZIME KAPITALE

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale.

II

Rialokimi dhe transferi në total është në shumë prej 105,097.00 € nga fondet 10, 21, 22 në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale sipas tabelave 4.1 dhe 4.2 të bashkangjitur këtij vendimi.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës .

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.09.2018





01/ Nr. 7723 /2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2018 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2019

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së kuvendit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2019.

II

Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit për vitin 2019 planifikon t'i mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e komitetit për politik dhe financa.

III

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hani të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

Vendimet/Çështjet

	Vendimet/Çështjet	
JANAR 2019	<ul style="list-style-type: none">Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2019.Plani i punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2019.Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2019.Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2019.Informatë mbi veprimtarit afariste.Propozim vendimi për ndarje e bursave për student.	
SHKURT 2019	<ul style="list-style-type: none">Informatë për raportin e punës së kryetarit të komunës për vitin 2018.Raporti i shpenzimeve buxhetore për vitin 2018.Raportit i punës së kuvendit të komunës për vitin 2018.Propozim vendim për bartjen (rialokimi) e buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.	
MARS 2019	<ul style="list-style-type: none">Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2018.Raportit i punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2018.Njoftimit për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2018.Njoftimit për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hani të Elezit për vitin 2018.	

PRILL 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2019. • Informatë për ndarjen e bursave. • Raporti tre mujor i N.P.L “Pastrimi” Sh.a. • Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2018. 	
MAJ 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2019. • Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit. • Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për "Javën Kulturore" 2019. 	
QERSHOR 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza afatmesme buxhetore 2020-2022. • Informatë për sektorin e emergjencave. • Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre. 	
KORRIK 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Prill – Qershor 2019. • Informatë mbi raportin e auditorit të përgjithshëm për Komunën për vitin 2018. • Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2018. • Propozim vendimi për themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2020. • Njoftimit për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2018. • Raporti gjashtë mujorë i N.P.L “Pastrimi” sh.a. 	
GUSHT 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2019. • Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2018-2019. • Rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020. • Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2020. • Informatë mbi raportin e shpenzimeve për "Javën Kulturore" 2019. • Informatë mbi Qarkoren e dytë të brendshme buxhetore. • Informatë për korrje shirjet. 	
SHTATOR 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i komunës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2021-2022. • Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2020. • Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2020. • Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2019/2020. 	
TETOR 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Korrik – Shtator 2019. • Rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020. • Informatë për raportin e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2018/2019 në SHFMU dhe SHML. • Raporti nëntë mujorë i N.P.L Pastrimi sh.a. 	

NENTOR 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi. • Informatë mbi gjendjen në shëndetësi. • Rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020.
DHJETOR 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Informatë e kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për vitin 2020. • Planit për transparencë për vitin 2020.

IV

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2019, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.

V

Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

VI

Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.

VII

Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

VIII

Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën III të këtij vendimi, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.

IX

Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2019, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2019.

X

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

XI

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.09.2018

